



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 175, datë 29.09.2023

**PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT DHE RIEMËRIMIT TË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË SË
BROKERIMIT NË SIGURIME “FIDENTIA” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22 të ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Përparim Isufi në pozicionin e Administratorit dhe riemërimit të z. Përparim Isufi dhe z. Ardian Spahiu, si anëtarë të Këshillit të Administrimit të shoqërisë së brokerimit në sigurime “Fidentia” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare.**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**